

Data 12.06.2023.

**PROCESVERBAL**  
**Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:**

**«“Blerje materiale per mirmbajtje Institucionesh Shkolla dhe Kopshte “**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

*Kodi CPV , 30192110-5,34941000-5,44111200-3,44171000-9,44831000-4,44831400-8,44921200-4,45261211-6,45261410-1,45261420-4,45410000-4.*

**VLERA E FONDIT LIMIT:**

**5 833 333,32**(Pesemilion e teteqind e tridhjete e tremije e treqind e tridhjete e tre presje tridhjete e dy )  
lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Bulqize** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

1. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

c) Formularin e ofertes ekonomike.

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

## **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

### **2.1. Përshatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):**

**Sipas kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

### **2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1.** Xhiroja mesatare vjetore për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare, duhet të ketë një vlerë të pakten 40 % të vlerës së parashikuar të kontratës, pa përfshirë vlerën e TVSH-së, për të cilin duhet të paraqitet vërtetim i leshuar nga administrata tatimore. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëq Operatorët Ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të pakten një vit të periudhës së kërkuar nga AK si më lart.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe nënën 64 të Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatimin mbiteardhurat", i ndryshuar, Udhëzimet e Ministrisë së Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Përtatimin mbiteardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjerat tatimore, vetëmnëpërmjet formëselekttronike", sidhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" etj.

**2.2.2.** Kopje të vërtetuara të bilancëve vjetore të viteve 2020 – 2021 -2022 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet që të tregojnë raportet midis aktivitetit dhe pasivit. Shenim: Në respektim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nënën 43, pika 4, kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në bilancet e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

**Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e informacionit të paraqitur në zbatim të Ligjit nr.162/2020 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar.**

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe neni 41, pika “c”, e ligjit nr.10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar” i ndryshuar, nëzbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Përtatiminmbitëardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Përtatiminmbitëardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Përdeklarimin e detyrueshëm të deklaratave të mëdha të dokumenteve të tjeratimore, vetëm nëpërmjet formëseletronike", etj.

### **2.3 Pervoja e ngjashme :**

**2.3.1.** Për të provuar përvojën e mëparshme, OE duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontrata të mëparshme , të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Vlera e kërkuar për realizimet e mëparshme duhet të jete të minimalisht deri në 20% e vlerës të kontrates që po prokurohet dhe që janë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontrates.

Per kete OE duhet te paraqese sidëshmi për përvojën e mëparshme,

- Vërtetimet të lëshuar nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kutëshënohet vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, kushënohendatat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. (Për kontratat në sektorin publik).
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, sidëshmi pranohet vetëm faturatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet timore, kushënohendatat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:**Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën minimalisht 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

### **Aftesite teknike dhe profesionale**

**2.3.2.** Deklarate nga OE që merr përsipër transportin e mallrave objekt prokurimi sipas kërkesave të Bashkisë Bulqize.

**2.3.3.**Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë për cilësinë dhe origjinën e mallrave, objekt i këtij prokurimi.

**2.3.4.** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë mostra për artikujt e ngjyrosur me te verdhe ne preventiv (nga 1 cope/1 artikull) . Dorëzimi i mostrave do të bëhet ditën e hapjes së tenderit para Zyres se Protokollit te Bashkise Bulqize, ato duhet të jenë të mbyllura ne kuti jo transparente të vulosur, së bashku me mostrat, ofertuesi duhe të bejë shoqërimin e mostrave me një shkresë të firmosur nga përfaqësuesi ligjor dhe vulosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mosparaqitja e të gjitha mostrave eshte kusht skualifikim.

- *Mallrat e dorezuaratëjenësipaspecificimevetekniketepercaktuara ne DST. Autoritetikontraktorpasitëvlerësojëmostrat do tjakthejëoperatoritekonomiknerespektimdhe ne zbatimtedispozitaveteLPP .Vleresimi i mallravedorezuara ,mostrave do tejetekusht per vleresimin e operatoritekonomik.*

**2.3.5.**Operatori ekonomik duhet te ofroje garanci per mallrat e ofruar si dhe nderrimin ne rast se nuk jane sipas specificimeve teknike te percaktuara nga AK . Per permbushjen e kesaj pike operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate te nenshkruar nga perfaqesuesi ligjor se operatori merr persiper zevendesimin e mallrave dhe levrimin sipas specificimeve teknike te percaktuara nga AK. Gjithashtu operatori ekonomik te perfshije ne deklarate duke garantuar AK se ofron garanci per mallrat objekt prokurimi duke i'u referuar periudhes se kerkuar ne specificimet teknike.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nennt 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë kapacitetet teknike dhe aftesite profesionale ne permbushjen dhe realizimin e kontrates, si edhe sherbejne per vleresimin e ofertes teknike/ekonomike.

## **2.4.Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim.**

**Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**

**Ne respektimtenenit 36, 37 te LPP-se ne tegjitharastetkurpermendet “marke” perfshihettermi “ekuivalent”.**

**Sqarim per ofertuesit : Ne respektimdhezbatimteLigjit nr.162/2020 date 23.12.2020 “ Per Prokurimin Publik ” neni 82 dhe VKM nr. 285, date 19.05.2021 ” Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”,neni 26 neni 39, Bashkë me dorëzimin e**

kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti kontraktor pranonsi provë paraprake**, në vend të disa vërtetimeve të lëshuar nga autoritetet publike ose palët treta, formularin për mbledhë të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së dhe nenit 26 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, tendryshuar. **Në dorast, përpara se të publikohen ofertimet e fituesit dhe përparnisjes së afatëve të ankimit, autoriteti kontraktor detyrimisht do t'ikërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provues për vetëdeklarimet në formularin për mbledhë të vetëdeklarimit, sidhe dokumentet e paraqitura sipas pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinalose në kopje të njësuara me origjinalin.**

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Te dhenat e mëposhteme janë përgatitur nga komisioni i perlllogaritjes së vlerës së fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike.(bashkangjitur DST)*

**Shënim : Ne rastet kur citohet në specifikimet teknike termi “marke” ose “ Cilesia e pare”, ky përcaktim është i barasvlefshëm me termin “ ekuivalente”.**

*NJESIA E PROKURIMIT*